



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI

Në bazë të neneve 11 dhe 17 shkronja k, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit, 19 shkronja k të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-1/298-10 dhe nenit 1 pika 3 të Rregullores për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr.1/172-400 të datës 27 shtator 2012, në kërkesë të OJQ Handikos në Podujevë nr.06-560/03-3725/17 të datës 24.01.2017, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 07 mars 2017, miratoi,

VENDIM

PËR MBËSHTETJE FINANCIARE OJQ-në HANDIKOS - QENDRA E REHABILITIMIT TË BAZUAR NË BASHKËSI NË PODUJEVË

Neni 1

OJQ Handikos – Qendra e Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi në Podujevë, për zhvillimin e aktiviteteve programore dhe mbulimin e shpenzimeve operative të veprimtarisë, sipas objektivave strategjike të OJQ - së, për vitin 2017, mbështetet me mjete financiare në shumë të gjithmbarshme prej 14,938.00 €.

Neni 2

Mjetet financiare sipas nenit 1 të këtij Vendimi ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Shuma e mjeteve bartet në konton bankare të OJQ - së përkatëse në këste proporcionale mujore.

Neni 3

Vendimin e zbaton Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-453/01-17277/17
Podujevë,
07 mars 2017



Kryesuesi i Kuvendit
Mejmet Gashi